



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration



MUNICIPAL PERFORMANCE GRANT
GRANTI I PERFORMANCËS KOMUNALE
OPŠTINSKI GRANT UČINKA

Rregullat e GRANTIT TË PERFORMANCËS KOMUNALE

për vitin fiskal 2025
bazuar në vlerësimin e performancës
për vitin fiskal 2023

Korrik, 2024



Tabela e përmbajtjes

Parathënie.....	4
1. Granti i performancës komunale - Hyrje	5
1.1 Hyrje.....	5
1.2 Baza juridike	5
1.3 Qëllimi.....	6
1.4 Temat kyçe	6
1.5 Mbulueshmëria gjeografike.....	6
1.6 Orientimi strategjik.....	7
1.7 Struktura e rregullave dhe audienca e synuar	8
2. Granti i performancës komunale– Parametrat dizajnues.....	9
2.1 Parimet themelore.....	9
2.2 Kushtet minimale.....	9
2.3 Treguesit e performancës komunale.....	10
2.4 Burimet e financimit të grantit të performancës komunale.....	12
2.5 Llogaritja e shumës së grantit të performancës komunale.....	13
2.6 Kriteret për shfrytëzimin e grantit të performancës komunale.....	13
2.7 Auditimi i grantit të performancës komunale	14
3. Granti i performancës komunale – Procesi i vlerësimit.....	15
3.1 Aranzhimet institucionale	15
3.1.1 Komisioni i grantit të performancës komunale.....	15
3.1.2 Grupi teknik	15
3.1.3 Komisioni i ankesave	15
3.2 Afati kohor.....	15
3.3 Procedurat e vlerësimit	16
3.3.1 Periudha e Vlerësimit për Grantin e Performancës Komunale (Ciklet e Menaxhimit të Grantit)	16
3.3.2. Përgatitjet për vlerësim të GPK-së	16
3.3.3. Mbledhja dhe vlerësimi i të dhënave	16
3.3.4. Komunikimi i rezultateve të komunave dhe procedura e ankesës	17
3.3.5. Finalizimi dhe publikimi i rezultateve të vlerësimit dhe ndarja e grantit	17
3.3.6. Masat për sigurimin e vlerësimit objektiv	18
4. Shtojcat	19
Shtojca 1: Udhëzuesi për vlerësim – Kushtet minimale	20
Shtojca 2: Udhëzuesi për vlerësim – Treguesit e performancës	22
Shtojca 3: Shablloni i fletëvlerësimit dhe udhëzuesi i pikëve.....	31
Shtojca 4: Shablloni për llogaritjen e shumave të ndara të grantit	49

Parathënie

Në vitin 2009, Kosova ishte vendi i parë në rajon që aprovoi skemën stimuluese financiare të bazuar në performancë, përmes ndarjes së fondeve për komunat si nxitje për përmirësimin e qeverisjes lokale. Në fund të vitit 2017, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), në partneritet me Agjensionin Zviceran për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), zhvilluan dhe u pajtuan të bashkëfinancojnë një skemë unike për ndarjen e grantit të performancës për komunat. Në vitin 2019, Suedia dhe Norvegjia kanë vendosur që të bashkëfinancojnë skemën e GPK. Në vitin 2022, BE përmes Suedisë poashtu i bashkohet financimit të skemës së GPK.

Ndërmjet viteve 2018 dhe 2021, rreth 14 milionë euro janë alokuar në komunat përfituese, si grante të performancës komunale. Ndërmjet viteve 2022-2025, shuma e grantit të performancës komunale pritet të jetë rreth 30 milionë euro. Ky grant synon përmirësimin e performancës së komunave në fushat: 'qeverisja demokratike', 'menaxhimi komunal' dhe 'ofrimi i shërbimeve'.

Granti i performancës komunale për vitin 2025 do t'iu ndahet komunave në pajtim me kriteret e llogaritjes së grantit dhe pikët e arritura në performancën komunale në bazë të një numri treguesish të shtrirë në tri fusha kryesore të përmendura si më lartë.

Shuma e grantit në vitin 2025 pritet të jetë rreth 7.8 milionë euro. Të gjitha komunat e Kosovës gëzojnë të drejtën e pjesëmarrjes në grantin e performancës komunale, sipas kushteve të përcaktuara në këto rregulla.

Granti i performancës komunale (GPK) ka për qëllim të nxisë konkurrencën ndërmjet komunave, duke ndjekur parimin që performanca më e mirë të shoqërohet me vlerë më të madhe të grantit. Së këndejmi, GPK synon të përkrahë komunat në dy mënyra: së pari, duke e inkurajuar pajtueshmërinë komunale me standardet minimale ligjore (standardet themelore); së dyti, duke stimuluar performancën 'reale' që shkon përtej kërkesave ligjore ('të detyrueshme').

GPK bazohet në parimet e mëposhtme:

- Komunat duhet të plotësojnë një numër kushtesh minimale që të mund të kualifikohen për grant në baza vjetore;
- Për të gjitha komunat që kanë plotësuar kushtet minimale, shuma e grantit që merr secila komunë bazohet në performancën e arritur në treguesit e performancës në krahasim me performancën e të gjitha komunave të tjera, si dhe elemente të tjera të kriterëve të vlerësimit siç përcaktohet në këto rregulla.

Pasi që komunat të kualifikohen, lartësia e grantit do të përcaktohet nga pikët relative të fituara në treguesit e performancës. Treguesit janë pasqyrim i objektivave të politikave të qeverisë, që synojnë realizimin e vizionit të përgjithshëm të komunave si *'institucione demokratike dinamike të qeverisjes lokale që ofrojnë shërbime cilësore dhe u përgjigjen nevojave dhe prioritetëve të qytetarëve'*.

Ky dokument përcakton objektivave të grantit, kushteve minimale, sistemin e tregueseve aplikohen në ciklet e vlerësimit, formulën e llogaritjes së vlerave të grantit, afatet, burimin e të dhënave dhe aspektet e sigurimit të cilësisë së tyre, si dhe çështje të tjera procedurale të grantit. Po ashtu, ky dokument informon të gjithë akterët lidhur me rregullat dhe procedurat e grantit të performancës.

MAPL-ja dhe kontributdhënësit inkurajojnë të gjithë akterët lokal që të konsiderojnë rezultatet e grantit të performancës komunale si mundësi për të kuptuar performancën e tyre. Po ashtu, rezultatet e grantit mundësojnë që komunat të jenë pjesë e konkurrencës së shëndoshë me komunat e tjera, për përmirësimin e kapaciteteve komunale dhe ofrimin e shërbimeve publike për qytetarë në menyrë efikase dhe efektive. të shërbimeve publike për qytetarë.

Rezultatet e vlerësimit të performancës komunale do të t'iu komunikohen të gjitha komunave, sipas afateve të parapara si dhe do të publikohen nga MAPL-ja.

1. Granti i performancës komunale - Hyrje

1.1 Hyrje

Komunat në Kosovë, si subjekte të qeverisjes së decentralizuar lokale, luajnë një rol të rëndësishëm në organizimin e sektorit publik. Përveç përgjegjësisë për ofrimin e një varg shërbimesh, komunat në njëërë anë shërbejnë si pikë e parë kontaktuese ndërmjet qytetarëve dhe shtetit dhe në anën tjetër, ato u japin mundësinë qytetarëve të marrin pjesë në vendimmarrje.

Administrata lokale konsiderohet një nga shtyllat kryesore të shtetit dhe promotor i zhvillimit social dhe ekonomik. Krahëuar me shumë vende të tjera, komunat në Kosovë qëndrojnë relativisht mirë në ofrimin e shërbimeve. Megjithatë, ende ka nevojë për përmirësime në ushtrimin e kompetencave vetanake komunale, si rrjedhojë është e pranishme nevoja për përmirësimin e kontrollit dhe menaxhimit financiar si dhe investime më të mëdha përmes projekteve strategjike. Institucionet lokale duhet t'i inkurajojnë nëpunësit publik për zhvillimin e vazhdueshëm të kapaciteteve të tyre, për të krijuar një administratë moderne lokale të aftë për ofrimin e shërbimeve efikase për të gjithë qytetarët pa dallim.

Të gjeturat nga raportet vendore dhe të institucioneve kredibile ndërkombëtare vazhdojnë të nënvizojnë nevojën për reformën e administratës publike. Kjo e fundit mbetet një ndër prioritetet kryesore strategjike të vendit, për çfarë kërkohet vëmendje e veçantë. Organet e pushtetit lokal duhet të shtojnë intensitetin e punës së tyre dhe të ofrojnë një qasje të re qeverisëse e cila do të rriste besueshmërinë e qytetarëve ndaj institucioneve të tyre lokale. Sigurisht që suksesi apo mospësuksesi do të varet nga angazhimi i përbashkët në ndërtimin e një administrate funksionale dhe përkushtimi i institucioneve komunale për të reaguar ndaj këtyre problemeve.

Marrë parasysh këtë, Granti i Performancës Komunale (tutje GPK) përcakton një numër objektivash për pushtetin lokal në mënyrë që të rriten kapacitetet institucionale në ushtrimin e kompetencave dhe trajtimin efektiv të çështjeve që ndikojnë në jetën e qytetarëve.

Lidhur me këtë, temat në vijim janë identifikuar si objektiva prioritare për përmirësimin e performancës komunale, si vijon:

- **Komunat të funksionojnë si institucione lokale demokratike** - që respektojnë standardet ligjore të transparencës, me kuvend komunal të fuqishëm që i përfaqëson qytetarët dhe ka pushtetin të mbikëqyrë ekzekutivin, ndërsa qytetarët kanë mundësinë të shfaqin shqetësimet dhe sugjerimet e tyre;
- **Komunat të kenë një menaxhim efektiv dhe efikas komunal** - që është neutral dhe i paanshëm; dhe
- **Komunat të ofrojnë shërbime cilësore** - në përgjigje ndaj prioriteteve dhe nevojave të qytetarëve, duke i trajtuar të gjithë në mënyrë të barabartë.

1.2 Baza juridike

Rregullat e Grantit të Performancës Komunale (GPK) janë të normuara me Ligjin nr. 08/l-103 - për sistemin e menaxhimit të performancës së komunave dhe skemën e grantit të bazuar në performancë dhe Udhëzimin Administrativ Nr. 01/2023 për menaxhimin e performancës komunale dhe skemën e grantit për performancën komunale.

Aspektet e tjera materiale dhe procedurale janë objekt i trajtimit në Rregullat e GPK-së të përcaktuara në këtë dokument.

1.3 Qëllimi

GPK-ja ofrohet në formë të përkrahjes financiare për komunitet dhe ka për qëllim stimulimin e tyre që të përmirësojnë performancën në fushën e qeverisjes lokale demokratike, menaxhimit komunal dhe ofrimit të shërbimeve.

1.4 Temat kyçe

Duke pasur parasysh analizën e faktorëve kritikë, të cilët mund t'i pengojnë komunitet të bëhen institucione demokratike dinamike të qeverisjes lokale që ofrojnë shërbime cilësore GPK -ja do të fokusohet në tre temat e mëposhtme:

- Qeverisja demokratike;
- Menaxhimi komunal;
- Ofrimi i shërbimeve.

Këto tre tema ndahen tutje në dhjetë nën-tema siç paraqitet më poshtë në Tabelën 1. Në kuadër të këtyre nën-temave janë identifikuar 30 tregues të performancës, prej të cilëve 27 tregues performance do të maten për performancën e vitit 2023¹. Kjo do t'i mundësojë komunave të marrin 90 pikë (prej 100 pikëve) në vlerësimin e performancës të vitit 2023. Nënkapitulli 2.3 ofron më tepër sqarime për këtë. Pikët e fituara përcaktojnë shumën e grantit që merr komuna duke u bazuar në performancën e saj.

Tabela 1: Tre temat kryesore dhe dhjetë nën-temat me pikët maksimale

Temat dhe nën-temat		Pikët që mund të merren
1. Qeverisja demokratike		40
I	Roli i kuvendit komunal si organ mbikëqyrës	12
II	Pjesëmarrja, konsultimi dhe gjithëpërfshirja e qytetarëve	12
III	Transparenca, qasja në informata dhe integriteti	16
2. Menaxhimi komunal		30
IV	Menaxhimi financiar	13
V	Menaxhimi i kontratës	7
VI	Menaxhimi i burimeve njerëzore	10
3. Ofrimi i shërbimeve		30
VII	Shërbimet administrative	6
VIII	Planifikimi hapësinor, transporti publik dhe mjedisi	8
IX	Arsimi para-universitar	8
X	Kujdesi parësor shëndetësor (KPSH)	8
Numri maksimal i pikëve që mund të merren për grantin e vitit 2025		100

1.5 Mbulueshmëria gjeografike

GPK është instrument financiar i krijuar për të gjitha komunitet e Kosovës. Qasje në GPK kanë të gjitha komunitet që plotësojnë kushtet minimale të përcaktuara në këtë dokument.

¹ Treguesi me numër 3, 16.b, 19, dhe 22 do të jenë të ngjirë për performancën e vitit 2023

1.6 Orientimi strategjik

GPK është grant shtesë për komunat i paraparë në Ligjin vjetor të buxhetit të Kosovës - tabela e alokimit të buxhetit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal. Qëllimi strategjik është integrimi i grantit të performancës komunale në ligjin për financat e pushtetit lokal të Kosovës ose Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.

GPK ofrohet si përkrahje shtesë për projektet kapitale të komunave, lartësia e të cilit përcaktohet në bazë të formulës për alokim të grantit të përgjithshëm për financimin e komunave, që kalkulohet bazuar në variablat vijuese: madhësia e popullsisë, madhësia gjeografike, përbërja etnike që llogariten mbi shumën fikse bazë², si dhe pikët e performancës në treguesit e grantit.

Për shpenzimin e Grantit të Performancës Komunale, zbatohen të gjitha rregullat ekzistuese të Qeverisë (të cilat zbatohen për investimet kapitale në kuadër të grantit të përgjithshëm) në aspektin e përdorimit të grantit, planifikimit të grantit, si dhe të raportimit dhe llogaridhënies. Kjo nënkupton që komunat mund të përdorin procedurat e tyre ligjore të tenderimit, kontraktimit dhe pranimi teknik. Granti mund të përfshihet në auditimin e rregullt (financiar dhe të pajtueshmërisë) të Zyrës Kombëtare të Auditimit. Pra, GPK administrohet si grant qeveritar për komunat. Veçoritë/karakteristikat e vetme që shtohen këtu janë kushtet minimale dhe treguesit e performancës.

Sa i përket shpenzimit të grantit të performancës komunale, të gjitha rregullat ekzistuese të qeverisë (të cilat zbatohen për investimet kapitale në kuadër të grantit të përgjithshëm), do të zbatohen në aspektin e përdorimit të grantit, planifikimit, raportimit dhe llogaridhënies. Kjo do të thotë se komunat mund të përdorin procedurat e tyre ligjore të tenderimit, kontraktimit dhe pranimi teknik. Granti mund të përfshihet në auditimin e rregullt të Zyrës Kombëtare të Auditimit.

Meqenëse GPK është rregulluar me Ligjin për performancë komunale dhe grant të performancës plani është që GPK të bëhet pjesë e kornizës ligjore për financat lokale në vitet e ardhshme si dhe duhet të harmonizohet sa më shumë që është e mundur me sistemet qeveritare dhe procedurat administrative aktuale të Kosovës.

Ministritë e linjës dhe kontributdhënësit që dëshirojnë t'iu delegojnë përgjegjësitë dhe fondet e ndërlidhura qeverive lokale do të inkurajohen t'i harmonizojnë grantet e tyre me dispozitat për GPK-së, të cilat bazohen në matjen e qeverisjes së mirë. Kjo do të krijonte avantazh edhe për grantin e tyre (sektorial) dhe GPK. Për shembull, mund të përdoren të njëjtat kushte minimale, ndoshta në kombinim me një përqindje minimale të pikëve (rezultatit) të performancës. Kontributdhënësit që dëshirojnë të investojnë në çështjet që kanë të bëjnë me qeverisje të mirë do të inkurajohen t'i kanalizojnë fondet e tyre drejtpërdrejt në fondin e përbashkët për GPK.

² Formula e alokimit për grantin e përgjithshëm është përkufizuar në Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal (Ligji nr. 03/ L- 049)

1.7 Struktura e rregullave dhe audienca e synuar

Ky dokument shpjegon kriteret, rregullat dhe procedurat për menaxhimin e Grantit të Performancës Komunale:

Kapitulli 1 – ofron një përmbledhje të shkurtër të justifikimit të GPK dhe fushave ku përqendrohet;

Kapitulli 2– përkufizon kushtet minimale, treguesit e performancës, si dhe parimet për ndarjen e grantit dhe auditimin e GPK;

Kapitulli 3 - prezanton procesin e vlerësimit të performancës komunale nga mbledhja e të dhënave e deri te ndarja e grantit.

Shtojcat japin udhëzime më të hollësishme të vlerësimit për:

- kushtet minimale -shtojca 1
- treguesit e performancës - ku jepen përkufizimet e asaj që matet, nga vijnë të dhënat dhe si maten (shtojca 2)
- Shtojca 3 -jep shabllonin për fletëvlerësimin dhe tregon si caktohen pikët e performancës që do të përdoret për komunikimin e rezultatit të performancës për komunat.
- Shtojca 4 -përshkruan hollësisht se si përlllogariten shumat e grantit për secilën komunë pasi të dihen pikët e performancës
- Shtojca 5 jep të dhënat kontaktuese.

2. Granti i performancës komunale– Parametrat dizajnues

2.1 Parimet themelore

GPK bazohet në parimet e mëposhtme:

- Komunat duhet që për secilin vit të plotësojnë një numër kushtesh minimale që të mund të kualifikohen për marrjen e grantit në baza vjetore (në pajtim me nenin 30.1 të Ligjit për sistemin e menaxhimit të performancës së komunave dhe skemën e grantit të bazuar në performancë);
- Për të gjitha komunat që kanë plotësuar kushtet minimale, granti që merr secila komunë bazohet në pikët e saj relative të arritura në treguesit e performancës komunale (pikët e saj në krahasim me ato të të gjitha komunave të tjera) si dhe kritereve të tjera të formulës së alokimit, në pajtim me nenin 30.2 të Ligjit për sistemin e menaxhimit të performancës së komunave dhe skemën e grantit të bazuar në performancë.

Kushtet minimale kanë për qëllim të sigurojnë që shuma në dispozicion t’iu ndahet vetëm komunave që janë në gjendje t’i shfrytëzojnë me efikasitet, efektivitet dhe ekonomicitet mjetet financiare; janë në gjendje të absorbojnë fonde dhe t’i shpenzojnë në mënyrë të përgjegjshme; kanë rishikuar aktet komunale të vlerësuara të kundërligjshme nga autoriteti mbikqyrës dhe kanë raportuar me kohë në SMPK.

Treguesit e performancës komunale (dhe pikët relative) kanë për qëllim të nxisin konkurrencën ndërmjet komunave për të siguruar burime financiare shtesë, por edhe synimin e të qenit ndër komunat me pikët më të larta në fushat kyçe të performancës. Publikimi i rezultateve të vlerësimit (dhe diskutimi publik lidhur me analizën e rezultateve të vlerësimit) është një aspekt i rëndësishëm i GPK-së.

2.2 Kushtet minimale

GPK për vitin 2025 përcakton katër kushte minimale si vijon:

1. Komunat duhet të kenë raportuar të dhënat në SMPK sipas afatit të përcaktuar në nenin 19.2 të Ligjit për SMPK/GPK³;
2. Komunat duhet të kenë respektuar obligimin ligjor për të rishqyrtuar aktet komunale të vlerësuara si të kundërligjshme nga autoriteti mbikëqyrës⁴;
3. Opinioni i auditimit duhet të jetë të paktën i pamodifikuar me theksim të çështjes; dhe
4. Komunat duhet të kenë shpenzuar 75% ose më tepër të buxhetit final për investime kapitale.

Prandaj, komunat të cilat nuk arrijnë të përmbushin cilindo nga katër kushtet e mësipërme, nuk mund të përfitojnë nga granti i performancës komunale.

Arsyetimi i kushteve minimale është që:

- Komunat duhet të kenë raportuar të dhënat në SMPK për performancën e vitit 2023, sipas afatit të paraparë.
- Granti do t’iu jepet atyre komunave që e kanë respektuar obligimin ligjor për t’i rishqyrtuar aktet komunale të vlerësuara si të kundërligjshme në vitin 2023, nga autoriteti mbikëqyrës⁵.
- Për të marrë grantin, komunat duhet të kenë sistem për menaxhim financiar mjaftueshëm të shëndoshë, siç dëshmohet nga raportet individuale të auditimit të rregullsisë (financiare dhe të pajtueshmërisë) për vitin 2023, të publikuara nga ZKA; dhe
- Granti do t’iu jepet vetëm atyre komunave që kanë dëshmuar se kanë kapacitete të mjaftueshme për të absorbuar fondet shtesë, siç tregohet nga shkalla e shpenzimit të buxhetit

³ Afati i raportimit të të dhënave të performancës nga komuna është 45 ditë kalendarike nga momenti i pranimit të kërkesës për raportim nga ministria

⁴ Rishqyrtimi për qëllime të GPK-së është kriter procedural, që nënkupton obligimin e komunës për të rishqyrtuar në Kuvendin e Komunës aktet e vlerësuara si të kundërligjshme në vitin 2023 nga autoriteti mbikëqyrës, pa presupozuar përmbajtjen përfundimtare të aktit të rishqyrtuar.

⁵ Autoritet mbikëqyrës nënkupton MAPL-në dhe ministritë e linjës

final për investime kapitale në raportet individuale të auditimit të rregullsisë (financiar dhe të pajtueshmërisë) për vitin 2023, të publikuara nga ZKA.

Të katër kushtet minimale duhet të plotësohen që komuna të kualifikohet për grantin e performancës komunale. Shtojca 3 jep shabllonin për t'i komunikuar secilës komunë rezultatet e vlerësimit të kushteve minimale.

Burimet e të dhënave për katër kushtet minimale janë përcaktuar në shtojcën 1 të këtyre rregullave.

2.3 Treguesit e performancës komunale

Burimi kryesor i të dhënave për treguesit e GPK-së është Sistemi për Menaxhimin e Performancës Komunale (SMPK) i MAPL-së.

Siç shihet në tabelën 2 më poshtë, janë identifikuar gjithsej 27 tregues të performancës komunale (tre tregues të ngjirë në këtë vlerësim dhe një dhe një tregues pjesërisht i ngjirë) brenda tre temave kryesore dhe dhjetë nëntemave (shih tabelën 1 më lart). **Është e rëndësishme të përmendet se 27 tregues do të vlerësohen për përcaktimin e grantit që jepet në vitin Fiskal 2025, për të cilët vlerësimi bëhet bazuar në performancën e vitit 2023. Numri maksimal i pikëve për 27 treguesit që do të vlerësohen është 90 pikë.**

Tabela 2: Përmbledhje e temave të grantit të performancës komunale për vlerësim të performancës 2023⁶

#	Fushat, nënfushat dhe treguesit	# maks. i pikëve
	QEVERISJA KOMUNALE - Roli i Kuvendit Komunal, Pjesëmarrja dhe Përfshirja e qytetarëve, Transparenca dhe Llogaridhënia	40
I	Roli i kuvendit komunal si organ mbikëqyrës	12
1	Miratimi me kohë i propozim buxhetit vjetor komunal	2
2	Diskutimi për raportet tremujore buxhetore nga Kuvendi Komunal	4
3	Diskutimi për raportin e performancës komunale nga Kuvendi Komunal për vitin e kaluar ⁷	2
4	Diskutimi i raportit të auditorit të jashtëm dhe planit të veprimit për adresimin e rekomandimeve në Kuvendin Komunal	2
5	Mbledhje të Kuvendit Komunal me pjesëmarrje të kryetarit të komunës	2
II	Pjesëmarrja, konsultimi dhe gjithëpërfshirja e qytetarëve	12
6	Pjesëmarrja e qytetarëve në konsultime publike, i disagreguar sipas gjinisë	4
7	Aktet komunale dhe dokumentet e politikave lokale të konsultuara me publikun	4
8	Dëgjime publike për KAB dhe buxhet komunal (proporcionalisht ndaj # banorëve)	4
III	Transparenca, qasja në informata dhe integriteti	16
9	Mbledhjet e kuvendit të bëra publike dhe transmetuara drejtpërdrejtë online	4
10	Përmbushja e kritereve të faqes zyrtare elektronike të komunës	3
11	Publikimi i dokumenteve të prokurimit publik të komunës	3

⁶ Shpjegimi më i hollësishëm i temave, treguesve dhe ngjyrave mund të gjendet në tekst dhe në shtojcën 2.

⁷ Treguesit e performancës me numër 3, 16b, 19 dhe 22 mbesin të ngjirë për performancën e vitit 2023. Treguesi 3, nuk mund të mater për arsye se nuk ka të dhëna të raportuara në SMPK për kete vit, ndërsa, treguesi 16b dhe 19 dhe 22 janë tregues të ri dhe nuk do të mater për arsye se komunat nuk kanë qenë të informuara dhe nuk kanë mbledhur të dhënat për këta tregues. Treguesit #27, 28 and 29 janë tregues të ri në GPK, por kanë qene tregues në SMPK, kështuqë, propozohet që këta tregues të mater për performancën e vitit 2023.

12	Publikimi i raporteve për procese të konsultimeve publike	4
13	Raportimi i planit vjetor të planit të integritetit para Kuvendit Komunal	2
II. MENAXHIMI KOMUNAL - Menaxhimi financiar, Menaxhimi i kontratës dhe Menaxhimi i BNj		30
IV	Menaxhimi financiar	13
14	Niveli i azhurnimit të regjistrit të tatimit në pronë	3
15	Niveli i mbledhjes së faturës së tatimit në pronë (pa borxhe, interesa, ndëshkime)	5
16 a	Niveli i adresimit të rekomandimeve të Zyrës Kombëtare të Auditorit	3
16 b	Niveli i adresimit të rekomandimeve të auditorit të brendshëm	2
V	Menaxhimi i kontratave	7
17	Zbatimi i planit të prokurimit	3
18	Përgatitja dhe publikimi i listës së pronave komunale të planifikuara për dhënie në shfrytëzim	4
VI	Menaxhimi i burimeve njerëzore	10
19	Përgatitja e planit për zhvillimin e personelit	2
20	Gratë në pozita udhëheqëse në institucionet e arsimit, shëndetësisë dhe kulturës	5
21	Gra të emëruara në postet politike në komunë	3
III. OFRIMI I SHËRBIMEVE - Qasja dhe cilësia e ofrimit të shërbimeve - Sipas sektorit		30
VII	Shërbimet administrative	6
22	Shërbimet administrative të thjeshtuara për zvogëlimin e barrës administrative në nivel komunal	4
23	Kërkesa të shqyrtuara për leje të ndërtimit	2
VIII	Planifikimi hapësinor, transporti publik dhe mjedisi	8
24	Sipërfaqja e territorit të komunave të mbuluar sipas planeve zhvillimore të komunës	3
25	Vendbanimet e përfshira në transportin lokal publik	3
26	Realizimi i Planit Lokal të Veprimit në mjedis	2
IX	Arsimi para-universitar	8
27	Plotësimi i kushteve të kërkuara me infrastrukturë, pajisje dhe mjete në institucionet e arsimit parauniversitar	4
28	Niveli i pajtueshmërisë me raportin e synuar nxënës për mësimdhënës	4
X	Kujdesi shëndetësor primar	8
29	Njësitë e shëndetësisë primare me pajisje dhe shërbime laboratorike sipas udhëzimit administrativ	4
30	Niveli i pajtueshmërisë me ekipet e mjekësisë familjare dhe shëndetit oral	4
Totali i pikëve		100
Totali pikëve për GPK 2025		90

Treguesit pasqyrojnë fushat e performancës komunale që: (i) konsiderohen të rëndësishme për një funksionim të mirë të strukturave komunale si subjekte të qeverisjes lokale demokratike dhe (ii) konsiderohen të kenë hapësirë për përmirësim, në të gjitha nivelet për të gjitha komunat. GPK përqendrohet në fushat ku komunat kanë nevojë dhe mund të bëjnë përmirësime të mëtejshme. Granti do të krijojë stimuj për të lehtësuar këtë ndryshim.

Treguesit e ndryshëm kanë pikë të ndryshme maksimale, në lidhje me peshën dhe rëndësinë e atribuar të tyre. Shtojca 3 ka një udhëzues të detajuar mbi caktimin e pikëve brenda pikëve maksimale. Pikët janë kalibruar në mënyrë të tillë që të shpërblehen nivele të mira dhe të pranueshme të performancës, por që

për secilin tregues, për performancën nën-optimale jepen shumë pak ose aspak pikë, që do të thotë se pikët me të vërtetë stimulojnë performancën e mirë (në vend të performancës mesatare). Kjo gjithashtu do të thotë se komunat që performojnë mirë në një numër treguesish do të marrin ndjeshëm më shumë pikë se ato që tregojnë performancë të zakonshme.

Është e rëndësishme të theksohet se treguesit janë përzgjedhur dhe formuluar në mënyrë të tillë që të jenë të arritshëm në të njëjtën mënyrë nga të gjitha komunat, pavarësisht nga popullsia, madhësia e territorit apo fuqia ekonomike. Në parim, treguesit pasqyrojnë atributet që të gjitha komunat *'duhet t'i kenë'* - pasi ato janë pjesë e qeverisjes së mirë lokale, gjë që ju takon të gjithë qytetarëve të Kosovës.

Treguesi nr. 3, 16b, 19 dhe 22 (me ngjyrë portokalli në Tabelën 2) janë tregues të 'ngrirë' që do të thotë se rezultati për këtë tregues nuk do të merret parasysh në totalin e pikëve për vlerësimin e performancës për vitin 2023. Treguesi 3 nuk do të matet për arsye se nuk ka të dhëna të raportuara në SMPK për këtë vit, ndërsa, treguesi 16b, 19 dhe 22 janë tregues të ri dhe nuk do të matet për arsye se komunat nuk kanë qenë të informuara dhe nuk kanë mbledhur të dhënat për këta tregues.

2.4 Burimet e financimit të grantit të performancës komunale

GPK për vitin 2025 pritet të bashkëfinancohet nga Qeveria e Kosovës (nga alokimi buxhetor i MAPL-së), Suedia, Bashkimi Europian dhe Zvicra.

Plani i financimit të GPK për vitin 2025 është siç tregohet në Tabelën 3 më poshtë. Të gjitha shumat e planifikuara për GPK janë indikative dhe janë subjekt i aprovimit nga Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe kontributdhënësve.

Për të monitoruar ndikimin e projekteve tek qytetarët, do të implementohet auditimi shoqëror në kuadër të GPK. Shuma për auditimin shoqëror për vitin 2025 është zbritur nga totali i shumës së GPK. Andaj në tabelën 3 është paraqitur shuma indicative e GPK që do t'i alokohet komunave⁸.

Tabela 3: Burimet e financimit të grantit të performancës komunale 2025 (në Euro)

Burimet e financimit	Vlera e GPK për vitin fiskal 2025
Qeveria e Republikës së Kosovës /MAPL	4,500,000 euro
Kontributdhënësit (BE, Zvicra, Suedia)	3,350,000 euro
Buxheti për auditim shoqëror	78,500 euro
Gjithsej fonde të GPK-së	7,850,000 euro
Fonde të cilat do të ju ndahen komunave	7,771,500 euro

⁸ Shumat e paraqitura në tabelën 3 nga fondet e donatorëve janë preliminare dhe mund të ndryshojnë në vartësi të fondeve të ndara nga donatorët.

2.5 Llogaritja e shumës së grantit të performancës komunale

Treguesit janë definuar në mënyrë të tillë që të gjitha komunat, pavarësisht nga madhësia, vendndodhja apo fuqia ekonomike, mund të jenë një performues i mirë, me kusht që të bëjnë përpjekje për të performuar si një qeveri lokale demokratike që i shërben popullatës së saj.

90% e shumës së përgjithshme të GPK ndahet bazuar në formulë, ndërsa 10% e shumës së përgjithshme ndahet për shpërblime shtesë për komunat në 3 vendet e para me performancën më të mirë.

Vendi i parë i merr 5% të shumës totale të grantit; vendi i dytë i merr 3% të shumës totale të grantit dhe vendi i tretë i merr 2% të shumës totale të grantit.

Nëse dy e më shumë komuna kanë të njëjtin rezultat të performancës, atëherë shuma e shpërblimit për vendin e përcaktuar ndahet bazuar në një vendim të veçantë, i cili miratohet nga komisioni i grantit të performancës komunale.

Shuma e GPK bazuar në formulë (90% e shumës së përgjithshme të GPK) përcaktohet nga:

- Performanca relative e secilës komunë e matur sipas treguesve të përcaktuar të performancës; dhe
- Pesha e grantit të performancës komunale në grantin e përgjithshëm të alokuar.

Në fakt, GPK do të ndahet në bazë të pikëve relative, në mënyrë të tillë që dy komuna të cilat kanë një rezultat të njëjtë do të marrin një shtesë relative të barabartë në pjesën e investimeve kapitale të grantit të përgjithshëm. Kjo do të thotë që të dy komunave do t'iu ndahet një grant që është e njëjta përqindje e grantit të tyre të përgjithshëm (ndërsa shumat absolute të grantit të performancës komunale do të ndryshojnë). Madhësia e shumës absolute është proporcionale me grantin e përgjithshëm. Arsyeimi për këtë është i qartë: një komunë që ka një grant të përgjithshëm më të madh ka nevojë për një shumë më të madhe për të pasur të njëjtin stimulim sa i përket përmirësimit të performancës së saj. Shtojca 4 tregon se si llogaritet ndarja e GPK.

2.6 Kriteret për shfrytëzimin e grantit të performancës komunale

Granti përdoret për të financuar projekte komunale në dobi të qytetarëve, konform rregullave dhe parimeve në vijim:

- GPK përdoret vetëm për investime kapitale dhe nuk mund të përdoret për paga, mallra, shërbime apo subvencione;
- Komuna është e lirë të vendosë për cilat investime do të përdoret granti i performancës komunale. Rekomandohet që komunat të fokusohen në projekte konkrete, të kufizuara në numër, për të shmangur procedurat e gjata administrative dhe për t'i shfrytëzuar mjetet brenda vitit fiskal⁹;
- Granti duhet të shfrytëzohet nga komuna konform legjislacionit në fuqi. Në rast se komuna nuk e shpenzon grantin konform këtyre rregullave dhe legjislacionit në fuqi, obligimet kontraktuale ndaj operatorëve ekonomik barten nga vetë komuna;
- Shfrytëzimi i grantit i nënshtrohet rregullave të mbikëqyrjes dhe kontrollit konform legjislacionit në fuqi për menaxhimin e financave publike dhe rregullave të grantit të performancës komunale.

⁹ Pjesa e fondeve të GPK-së e financuar nga donatorët shfrytëzohet sipas marrëveshjes me donatorë.

2.7 Auditimi i grantit të performancës komunale

Shpenzimet e GPK-së mund të auditohen si pjesë e auditimit të rregullt nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

- MAPL-ja dhe kontributdhënësit mund të dakordohen që të bëhet një *auditim vjetor i posaçëm*, për të shqyrtuar aspekte të caktuara në lidhje me GPK. Auditimi mund të përfshijë funksionimin e GPK-së, proceset e prokurimit, procedurat e pranimit teknik të shërbimeve, pagesat, etj. Detajet për këtë auditim specifikohen në bashkëpunim me kontributdhënësit.
- Në rast të konstatimit të shkeljeve dhe parregullsive të evidentuara nga auditimit, si keqdeklarime materiale, MAPL-ja dhe kontributdhënësit mund të vendosin për përjashtimin e komunës nga e drejta e përfitimit të grantit për një periudhë të caktuar, në pajtim me nenin 23.3 të Ligjit për SMPK/GPK.
- Për të monitoruar ndikimin e projekteve tek qytetarët, do të zbatohet auditimi shoqëror, si pjesë e GPK-së. Auditimi shoqëror do të përfshijë monitorimin e performancës dhe proceset e planifikimit të projekteve në nivel komunal. Auditimi shoqëror do të paguhet nga një pjesë e fondeve të GPK (pjesa e donatorëve dhe nga subvencionet e MAPL-së) dhe do të kryhet nga organizata të shoqërisë civile. Rezultatet e auditimit shoqëror i raportohen Komisionit të GPK-së.

3. Granti i performancës komunale – Procesi i vlerësimit

3.1 Aranzhimet institucionale

Komisioni i grantit të performancës komunale dhe grupi teknik janë organet përgjegjëse për vlerësimin dhe ndarjen e grantit të performancës komunale. Ndërsa, komisioni i ankesave shqyrton dhe vendosë lidhur me ankesat e komunave¹⁰.

3.1.1 Komisioni i grantit të performancës komunale

Komisioni i grantit të performancës komunale është organi më i lartë vendimmarrës për GPK. Përbërja e komisionit të grantit është përcaktuar në Ligjin e SMPK/GPK në nenin 28.2, derisa detyrat dhe përgjegjësitë e këtij komisioni janë përcaktuar në nenin 20.1 të Udhëzimit Administrativ për SMPK/GPK.

3.1.2 Grupi teknik

Grupi teknik është organ i nivelit profesional i përbërë nga zyrtarë publik të njësisë përgjegjëse për performancë komunale dhe nga përfaqësues të subjekteve kontributdhënëse. Përbërja e grupit teknik është përcaktuar në nenin 28.4 të Ligjit për SMPK/GPK, derisa detyrat dhe përgjegjësitë e të njejtës janë përcaktuar në nenin 20.2 të Udhëzimit Administrativ për SMPK/GPK.

3.1.3 Komisioni i ankesave

Komisioni i ankesave shqyrton dhe vendosë lidhur me ankesat e parashtruara nga komunat lidhur me vlerësimin e performancës së tyre për GPK. Përbërja e komisionit të ankesave është përcaktuar në Nenin 28.5 në Ligjin për SMPK/GPK. Komisioni i ankesave nuk do të rishikojë ankesat që ndërlidhen me burimin e të dhënave të përdorur gjatë vlerësimit.

Anëtarët e komisioni të grantit apo grupit teknik nuk mund të jenë anëtarë të komisionit të ankesave.

3.2 Afati kohor

Procesi i vlerësimit të GPK-së fillon pas publikimit të raportit vjetor të performancës së komunave për vitin paraprak. Pra, pas datës 31 Maj fillon çdo vit kur të dhënat në lidhje me performancën komunale bëhen të disponueshme. Tabela më poshtë tregon afatin kohor tentativ të ndarjes së grantit për vitin 2025 bazuar në vlerësimin e performancës së vitit 2023.

Tabela 4: Afati kohor i procesit të vlerësimit

Aktiviteti	GPK 2025
Miratimi i rregullave ¹¹	Korrik 2024
Mbledhja e të dhënave	Korrik 2024
Procesi i vlerësimit/pikëve	Gusht 2024
Miratimi i rezultateve të vlerësimit	Gusht 2024
Komunikimi i rezultateve tek komunat	Gusht 2024
Periudha për ankesa	Shtator 2024
Konfirmimi i rezultateve përfundimtare dhe shumave të grantit	Shtator 2024
Transferimi i mjeteve	Janar - Shkurt të vitit vijues
Shfrytëzimi i mjeteve	VF vijues ¹²

¹⁰ Ligji Nr. 08/I-103 për Sistemin e Menaxhimit të Performancës së Komunave dhe Skemën e Grantit të bazuar në performancë, neni 28

¹¹ Sipas ligjit Nr. 08/I-103 për SMPK/GPK, skema e treguesve të grantit të performancës ashtu siç përcaktohet rregullat e grantit nuk mund të ndryshohet në një periudhë më të shkurtër se 3 vite nga hyrja në fuqi e tyre.

¹² Pjesa e fondeve të GPK e financuar nga donatorët mund të shfrytëzohet sipas marrëveshjes me donatorët

3.3 Procedurat e vlerësimit

3.3.1 Periudha e Vlerësimit për Grantin e Performancës Komunale (Ciklet e Menaxhimit të Grantit)

Periudha e vlerësimit për grantin e performancës komunale ndahet në 3 faza kryesore:

- 1.1. Periudha e performancës** - që nënkupton vitin për të cilin vlerësohet performanca e komunës. Në bazë të këtyre rregullave të GPK 2025 vlerësohet performanca komunale e vitit 2023;
- 1.2. Periudha e vlerësimit** - nënkupton periudhën në të cilën kryhet vlerësimi i performancës për GPK; pra performanca komunale për GPK vlerësohet në vitin 2024 për vlerësimin e performancës së vitit 2023;
- 1.3. Periudha e ndarjes dhe shfrytëzimi i grantit** - nënkupton vitin në të cilin granti vihet në dispozicion për shfrytëzim nga komunat. Në bazë të këtyre rregullave, Granti do të jetë në dispozicion për komunat në vitin 2025.

3.3.2. Përgatitjet për vlerësim të GPK-së

Procedurat përgatitore për vlerësim të GPK-se, janë si vijon:

- Grupi teknik përgatit rregullat e GPK-së për vitin fiskal 2025 (viti i alokimit) për performancën e komunave të vitit 2023.
- Rregullat e hartuara i dorëzohen Sekretarit të Përgjithshëm të MAPL-së dhe kontributdhënësve.
- Rregullat e GPK-së para vlerësimit miratohen nga Ministria, sipas nenit 28.2 në Udhëzimin administrativ për SMPK/GPK.
- Pas miratimit, Rregullat e GPK-së i'u shpërndahen komunave dhe publikohen në uebfaqen e MAPL-së.
- Procesi i vlerësimit fillon sipas afatit kohor të përcaktuar në tabelën 4 të këtyre rregullave.

3.3.3. Mbledhja dhe vlerësimi i të dhënave

Grupi teknik mbledh të dhënat për vlerësimin e grantit të performancës komunale. Këto të dhëna burojnë nga dokumentet e mëposhtme:

- 1) Raporti i Sistemit për Menaxhimin e Performancës Komunale për vitin 2023 (SMPK) i MAPL-së, i publikuar nga MAPL;
- 2) Raporti për vlerësimin e ligjshmërisë janar – dhjetor 2023, MAPL i MAPL-së
- 3) Raportet e auditimit të rregullsisë (financiare dhe të pajtueshmërisë) për vitin 2023 për secilën prej 38 komunave, të publikuara nga ZKA;

Të dhënat e përdorura nga këto burime mundësojnë identifikimin e komunave të cilat i plotësojnë katër kushtet minimale për grantin e performancës komunale (shih Shtojcën 1). Të dhënat po ashtu përdoren për të vlerësuar treguesit e GPK-së (shih Shtojcën 2). Pas kësaj, fletëvlerësimi (shih shabllonin në shtojcën 3) do të plotësohet me rezultatet për çdo komunë. Pikët totale do të regjistrohen në tabelën e ndarjes së grantit, e cila do të llogarisë shumën e grantit të performancës komunale për secilën komunë që është kualifikuar (shtojca 4).

3.3.4. Komunikimi i rezultateve të komunave dhe procedura e ankesës

Pasi që Komisioni i GPK-së të ketë miratuar rezultatet e vlerësimit për GPK, MAPL-ja brenda 7 ditësh, komunikon fletëvlerësimet në komuna. Komunikimi i rezultateve të performancës së komunës përkatëse bëhet vetëm për dhënie të informatës nëse komuna është kualifikuar ose jo, si dhe pikëve të performancës për GPK. Shumat dhe rangimi i komunave do të komunikohen vetëm pas përmbylljes së procesit të ankesave.

Me rastin e komunikimit të rezultateve, komunat kanë të drejtë të ankohen brenda **7 ditësh nga momenti i pranimi të fletëvlerësimit nga ministria**, në rast se nuk pajtohen me rezultatet e vlerësimit.

Ankesa mund të parashtrohet nga komunat për arsye procedurale dhe materiale të vlerësimit të GPK-së.

Ankesa nuk mund të kundërshtojë burimin e të dhënave zyrtare të përdorura gjatë vlerësimit.

Nëse një komunë, pretendon se organet përgjegjëse për GPK kanë bërë gabime në vlerësimin e performancës së saj, mund të shfrytëzoj të drejtën e ankesës sipas procedurave të mëposhtme:

Hapat dhe afatet kohore në një proces ankimi		
1.	Nëse, pas marrjes së fletëvlerësimit, komuna është e mendimit se janë bërë gabime procedurale ose materiale në vlerësimin për grantin e performancës, komuna ka të drejtë të parashtrij ankesë te komisioni i ankesave. Ankesa duhet të: • Arsyetohet me të dhëna faktike; • Nënshkruhet nga kryetari i komunës dhe të jetë e protokoluar; • Dorëzohet me shkrim në: Komisionin e ankesave Ministria e Pushtetit Lokal E-mail: info.mapl@rks-gov.net Pas dorëzimit të ankesës, MAPL konfirmon me shkrim pranimin e ankesës.	Brenda 7 ditësh nga marrja e fletëvlerësimit, para orës 16:00
2.	Komisioni i ankesave i shqyrton ankesat dhe merr vendim lidhur me ankesat e parashtruara.	Brenda 7 ditësh pas mbylljes së afatit të ankesës
3.	Në rast të ndryshimit të rezultateve të vlerësimit si rezultat i Vendimit të Komisionit të ankesave, Komisioni i GPK-së, përmes Grupit Teknik, bën ndryshimin e raportit të vlerësimit dhe e njofton komunën	Brenda 10 ditësh pas vendimit të Komisionit të ankesave

Në rast se një ankesë e një ose më shumë komunave rezulton e suksesshme dhe ndikon në ndryshimin e rezultateve të GPK-së, kjo do të ketë ndikim në shumën e grantit të komunave tjera. Të gjitha ndryshimet në ndarjen e grantit pas procesit të ankesave, miratohen nga Komisioni i GPK-së.

3.3.5. Finalizimi dhe publikimi i rezultateve të vlerësimit dhe ndarja e grantit

Pasi që komisioni i ankesave të ketë vendosur për ankesat, Komisioni i GPK-së përmes grupit teknik i bën ndryshimet në raportin e vlerësimit si dhe ndarja pasuese e grantit të performancës komunale konsiderohet përfundimtare.

Rezultatet përfundimtare dhe shumat e grantit do të komunikohen tek komunat në mënyrë që ato të mund të planifikojnë shfrytëzimin e grantit të performancës komunale.

MAPL-ja publikon raportin përfundimtar të vlerësimit të performancës në ueb-faqen e saj.

3.3.6. Masat për sigurimin e vlerësimit objektiv

Ekziston rreziku për gabime gjatë procesit të vlerësimit të komunave për GPK. Kjo nënkupton që vlerësimi joobjektiv të ndikoj në shpërndarjen jomeritore të grantit të performancës.

Për të evituar këtë rrezik, Ligji për SMPK/GPK, Udhëzimi Administrativ për SMPK/GPK, si dhe Rregullat e Grantit për performancë përcaktojnë mekanizmat e sigurimit të cilësisë si vijon:

- Procesin e verifikimit - i cili mundëson krahasimin e të dhënave të raportuara me dokumentet ose faktet që dëshmojnë vërtetësinë;
- Zbatimin e procedurave të ankesave si në rastin e hartimit të raportit të performancës, ashtu edhe në procesin e vlerësimit për GPK.
- Përfshirjen e kontributdhënësve në të gjitha proceset e vlerësimit të performancës dhe GPK-së;
- Përfshirjen aktive të shoqërisë civile në cilësinë e vendimmarësve (në komisionin për ankesa të GPK) si dhe në cilësinë e vëzhguesve në Komisionin e GPK-së dhe mundësisht në Grupin Teknik;
- Verifikimin e cilësisë së alokimit të grantit nga konsulentë të jashtëm (opsionale).
- Mundësinë e shpalljes së pavlefshme të të dhënave të performancës në rastet e mospërbushjes së kriterëve të cilësisë (neni 23 i Ligjit për SMPK/GPK) konform Metodologjisë përkatëse;

4. Shtojcat

Shtojca 1: Udhëzuesi për vlerësim – Kushtet minimale

#	Kushti minimal	Përkufizimi i kushtit minimal	Baza ligjore	Burimi i të dhënave	Kriteri Komuna i ka përmbushur / nuk i ka përmbushur
1	Komunat duhet të kenë raportuar të dhënat në SMPK sipas afatit të përcaktuar;	Komunat duhet të kenë raportuar për performancën e tyre në SMPK sipas afatit të përcaktuar në Ligjin për sistemin e menaxhimit të performancës komunale dhe skemën e grantit të bazuar në performancë.	Ligjin nr. 08/L-103 - për sistemin e menaxhimit të performancës së komunave dhe skemën e grantit të bazuar në performancë, neni 19.2.	Raporti i SMPK-së 2023, MAPL	Po , nëse komuna ka raportuar me kohë në SMPK Jo , Nëse komuna nuk ka raportuar me kohë SMPK.
2	Komunat duhet të kenë respektuar obligimin ligjor për t'i rishqyrtuar aktet komunale të vlerësuara si të kundërligjshme nga autoriteti mbikëqyrës	Komunat duhet t'i kenë rishqyrtuar të gjitha aktet komunale të vlerësuara si të kundërligjshme në vitin 2023 nga autoriteti mbikëqyrës. Rishqyrtimi për qëllime të Grantit të Performancës Komunale është kriter procedural, që nënkupton obligimin e komunës për të rishqyrtuar në Kuvendin e Komunës aktin e vlerësuar si të kundërligjshëm nga autoriteti mbikëqyrës, pa presupozuar përmbajtjen përfundimtare të aktit të rishqyrtuar.	Ligji nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale	Raporti për vlerësimin e ligjshmërisë janar – dhjetor 2023, MAPL	Po , nëse komuna ka kryer rishqyrtimin e akteve ligjore nga kuvendi komunal Jo , nëse komuna nuk ka kryer rishqyrtimin e akteve ligjore nga kuvendi komunal
3	Opinion i auditimit duhet të jetë të paktën i	Opinion i vjetor i auditimit së paku i 'Pamodifikuar me theksim të çështjes' ¹³	Ligji nr.03/L-048 për Menaxhimin e financave	Raportet individuale të auditimit të rregullsisë	Po , nëse komuna merr <i>Opinion të pamodifikuar ose Opinion të</i>

¹³ ZKA ofron lloje të ndryshme të opinionëve:

Opinion i pamodifikuar:

- Nëse konstatohet se janë përgatitur pasqyrat financiare, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kornizën financiare në fuqi

Opinion i kualifikuar:

- Nëse posedon dëshmi të mjaftueshme të auditimit të duhur, auditori konstaton se gabimet, individualisht ose në tërësi, janë materiale, por jo të përhapura, në pasqyrat financiare; ose
- Nëse auditori nuk ishte në gjendje të sigurojë dëshmi të mjaftueshme të auditimit të duhur mbi të cilën do të bazonte një opinion, por konkludon se efektet në pasqyrat financiare të çdo gabimi të pazbuluar mund të jenë materiale por jo të përhapura

Opinion i kundërt:

- Nëse posedon dëshmi të mjaftueshme të auditimit të duhur, auditori konstaton se gabimet, individualisht ose në tërësi, janë si materiale ashtu edhe të përhapura në pasqyrat financiare

Refuzon dhënien e Opinionit :

- Nëse nuk ka qenë në gjendje të posedojë dëshmi të mjaftueshme të auditimit të duhur mbi të cilën do ta bazonte opinionin, auditori konstaton se efektet në pasqyrat financiare të çdo gabimi të pazbuluar mund të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka vendosur një kufizim në fushëveprimin e auditimit të cilën auditori e konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose refuzon dhënien e një opinionin mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë që menaxhmenti ta heq kufizimin.

	pamodifikuar me theksim të çështjes;		publike dhe përgjegjësitë (LMFPP) Rregullorja nr.01/2017 për raportimin vjetor financiar nga organizatat buxhetore e nxjerrë nga MF-ja. Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik. Ligji nr. 05/I-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, neni 18	(financiare dhe të pajtueshmërisë) për vitin 2023, të publikuara nga ZKA	<i>Pamodifikuar me theksim të çështjes;</i> Jo , nëse komuna merr <i>Opinion të Kualifikuar ose të Kundërt, dhe nëse ZKA refuzon dhënien e opinionit</i>
4	Komunat duhet të kenë shpenzuar 75% ose më tepër të buxhetit final për investime kapitale	Të paktën 75% e buxhetit final për investime kapitale i shpenzuar	Rregulli financiar nr.01-2013 i LMFPP-së për shpenzimet e parasë publike	Raportet individuale të auditimit të rregullsisë (financiare dhe të pajtueshmërisë) për vitin 2023, të publikuara nga ZKA - ja.	Po , në qoftë se komuna ka shpenzuar së paku 75% ose më tepër të buxhetit final për investime kapitale Jo , në qoftë se komuna ka shpenzuar më pak se 75% të buxhetit final për investime kapitale

Theksim i çështjes:

- Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesit në një çështje të paraqitur ose të shpalosur në pasqyrat financiare që është e një rëndësie të tillë që është thelbësore për ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ekziston dëshmi e mjaftueshme adekuate se çështja nuk është materialisht e gabuar në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e theksimit të çështjes në raportin e auditorit. Paragrafi me Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose të shpalosur në pasqyrat financiare.

Shtojca 2: Udhëzuesi për vlerësim – Treguesit e performancës

Tabela më poshtë paraqet 30 treguesit e performancës. Mënyra se si maten treguesit nga SMPK, është përshkruar në dokumentet e SMPK-së. Në tabelën më poshtë janë dhënë përkufizimet e shkurtëra se si maten treguesit. Për vlerësimin e performancës së vitit 2023, për vitin fiskal 2025, treguesi nr. 3, 16b, 19,22 nuk merret për bazë në vlerësimi.

#	Treguesi	Përkufizimi i shkurtër
I . QEVERISJA DEMOKRATIKE		
I	Roli i kuvendit komunal si organ mbikëqyrës	
1	Miratimi me kohë i propozim buxhetit vjetor komuna	Treguesi mat shkallën e përmbushjes së obligimit ligjor të organeve komunale në lidhje me përgatitjen dhe miratimin e dokumentit, propozim i buxhetit vjetor komunal nga ana e Kuvendit Komunal brenda afatit të përcaktuar ligjor. Përshkrimi ligjor për procesin e përgatitjes dhe miratimit të dokumentit propozim i buxhetit vjetor komunal buron nga ligji i përgjithshëm për menaxhimin e financave publike, kurse kompetenca buron nga ligji për vetëqeverisje lokale Matja e performancës së këtij treguesi bazohet në dëshmitë si në vijim: i) Dorëzimi i buxhetit nga Kryetari i Komunës tek Kuvendi i Komunës para datës 1 shtator; ii) Miratimi i buxhetit nga Kuvendi i Komunës para datës 30 shtator.
2	Diskutime për raportet tremujore buxhetore nga Kuvendi Komunal	Ky tregues ka për qëllim matjen e shkallës së përmbushjes së obligimit ligjor të organeve komunale në lidhje me prezantimin dhe diskutimin para Kuvendit Komunal të raporteve financiare 3 mujore. Raportet duhet të paraqiten para kuvendit nga ana e kryetarit të komunës. Akti i matjes së përmbushjes së obligimit për diskutime të raporteve 3 mujore të buxhetit para Kuvendit Komunal, i referohet vitit paraprak fiskal. Për matjen e këtij treguesi kërkohen dëshmitë se kryetari ka paraqitë raportet e buxhetit para Kuvendit Komunal për çdo 3 mujor paraprak, më së largu 30 ditë nga përfundimi i tremujorit 38 për të cilin raportohet, në pajtim me dispozitën ligjore dhe po ashtu kryetari obligohet të dorëzoj një kopje të raportit edhe pranë Ministrisë së Financave në afatin e njëjtë kohor (më së largu 30 ditë pas përfundimit të 3 mujorit). Me rastin e paraqitjes së raporteve para kuvendit, i njëjti ka mundësi dhe obligim për të diskutuar dhe për të vepruar në kuadër të obligimeve që ka Kuvendi Komunal si organi më i lartë i komunës lidhur me punën e kryetarit dhe pjesës ekzekutive në zbatimin e buxhetit.
3	Diskutimi për raportin e performancës komunale nga Kuvendi Komunal për vitin paraprak	Me këtë tregues matet niveli i gatishmërisë së ekzekutivit për të diskutuar në Kuvendin e Komunal raportin e performancës komunale të vitit paraprak. Raporti i performancës publikohet nga MAPL-ja dhe atë deri më 31 maj të vitit kur bëhet vlerësimi. Diskutimi më së largu 60 ditë nga momenti i publikimit nga MAPL bëhet me qëllim të sinkronizimit të veprimeve gjatë periudhës së planifikimeve buxhetore, në mënyrë që ky raport të shërbej si referencë në këtë drejtim. Treguesi matë llogaridhënien e ekzekutivit para Kuvendit Komunal, me ç ’rast diskutohen të gjeturat e raportit, duke përfshirë cilësinë e shërbimeve dhe rezultatet e punës së autoriteteve komunale. Diskutimi i këtij

		raporti ndikon në planifikim të aktiviteteve për vitin vijues dhe organizimin më të mirë të resurseve bazuar në rezultatet e matjes nga SMPK.
4	Diskutimi i raportit të auditorit të jashtëm dhe planit të veprimit për adresim të rekomandimeve në Kuvendin Komunal	Ky tregues ka për qëllim të matë shkallën e prezantimit të raporteve të auditimit të jashtëm (ZKA) duke përfshirë planin e veprimit për gjetjet dhe rekomandimet dhe dërgimin për diskutim në Kuvendin Komunal. Treguesi matë nëse raporti i jashtëm i auditimit është dorëzuar në Kuvendin Komunal për diskutim në vitin e vlerësuar (d.m.th. raporti i auditimit të jashtëm i vitit 2021 duhet të diskutohet nga Kuvendi Komunal në vitin 2022).
5	Mbledhje të Kuvendit Komunal me pjesëmarrje të kryetarit të komunës	Ky tregues ka për qëllim matjen e shkallës së pjesëmarrjes të kryetarit të komunës në seancat e Kuvendit Komunal (të rregullta dhe të jashtëzakonshme). Kuadri ligjor obligon kryetarin për të raportuar para kuvendit së paku dy herë në vit lidhur me çështjet ekonomike-financiare të komunës, si dhe për zbatimin e planeve investuese. Po ashtu, kryetari është i obliguar për tu paraqitur në seancat e kuvendit sa herë kuvendi e kërkon këtë nga kryetari. Ligji po ashtu përcakton numrin minimal të mbledhjeve të Kuvendit Komunal, në më së paku 10 seanca në vit, 5 prej të cilave duhet të mbahen gjatë gjashtë muajve të parë. Takimet shtesë mbi numrin minimal mbesin në diskrecion të Kuvendit Komunal.
II	Pjesëmarrja, konsultimi i qytetarëve dhe gjithëpërfshirja	
6	Pjesëmarrja e qytetarëve në konsultime publike, i disagreguar sipas gjinisë	Për skemën e grantit, ky tregues grumbullon leximet nga dy tregues të SMPK-së, gjegjësisht treguesi 3.1.2 dhe treguesi 13.2.3; Treguesi 3.1.2. matë shkallën e pjesëmarrjes së qytetarëve në konsultime publike si takimet e rregullta me qytetarë, dëgjimet buxhetore, dhe takimet konsultative për akte komunale dhe dokumente të politikave lokale. Ky tregues e matë nivelin e pjesëmarrjes së qytetarëve në takime publike të organizuara nga komuna krahasuar me numrin e banorëve. Niveli 3% i numrit të banorëve është marrë si nivel i mjaftueshëm i pjesëmarrjes për gjitha komunat, së paku për një periudhë të përkohshme. Treguesi 13.2.3 Treguesi i referohet përkushtimit të komunës për përfshirjen e integritetit gjinor në dokumente strategjike, politika, plane si dhe masave që komuna synon të zbatojë për avancimin e barazisë gjinore. Treguesi matë nëse komuna e ka të miratuar planin për barazi gjinore dhe nivelin e implementimit të planit vjetor, duke marrë parasysh aspektet ligjore dhe dokumentet strategjike në nivel qendror. Një komunë konsiderohet se e ka planin komunal për barazi gjinore nëse ai plan është i miratuar direkt ose indirekt (përmes një dokumenti afatgjatë) në domethënëse për të marrë pjesë në proceset vendimmarrëse të komunës. Treguesi nuk matë cilësinë e pjesëmarrjes, përkatësisht nuk matë kontributin e grave apo vajzave pjesëmarrëse në takimet publike
7	Aktet komunale dhe dokumentet e politikave lokale të konsultuara me publikun	Treguesi matë zbatimin e obligimit ligjor për përfshirjen e publikut në procesin e vendimmarrjes në organet komunale. Të gjitha takimet që mbahen me qytetarët për një akt komunal apo dokument për përgatitje të një politike lokale, llogaritet një konsultim dhe raportohet se akti komunal apo dokumenti i politikës publike është konsultuar dhe është bërë transparent para miratimit të tij me qytetarët.

		Komunat obligohen të konsultohen me qytetarë para miratimit të këtyre akteve komunale: Draft - Statutin e Komunës, projekt-rregulloret komunale dhe projekt-akteve tjera që parashihen me ligjet sektoriale, si dhe për këto dokumente të politikave lokale: Strategjitë zhvillimore dhe planet e veprimit në fusha sektoriale, projekt-planet hapësinore, dokumentet tjera të parapara me legjislacion tjetër apo që komuna e vlerëson se janë të nevojshme të kalojnë në konsultim publik ²⁹
8	Dëgjime publike për Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB) dhe buxhet komunal (proporcionalisht ndaj # banorëve)	Treguesi matë zbatimin e obligimit ligjor për përfshirjen e publikut në procesin e vendimmarrjes në organet komunale, si dhe matë numrin e dëgjimeve buxhetore për 10,000 banorë. Për buxhetin komunal duhet të hartohen dy dokumente: 1) Korniza afatmesme buxhetore; dhe 2) buxheti komunal. Korniza afatmesme buxhetore fillimisht miratohet nga komiteti për politika dhe financa dhe përfundimisht nga Kuvendi Komunal dhe i dorëzohet Ministrisë së Financave deri më 30 korrik të vitit përkatës. Dokumenti i dytë – projekt buxheti komunal propozohet nga kryetari i komunës në Kuvendin Komunal deri më 1 shtator. Po ashtu, treguesi matë nëse komuna ka ndarë të paktën 1% të buxhetit për buxhetim me pjesëmarrje.
III	Transparenca, qasja në informata dhe integriteti	
9	Mbledhjet e kuvendit të bëra publike dhe transmetuara drejtpërdrejtë online	Treguesi matë se sa organet komunale i informojnë qytetarët e tyre për mbledhjet e kuvendit nëpërmjet publikimit të tyre në platformat ⁸ që janë të qasshme për publikun (përmes rrjeteve sociale apo forma alternative të komunikimit me publikun) dhe sa publike janë seancat e kuvendit komunal për t'u shikuar online nga publiku i interesuar. Seancat e kuvendit komunal duhet të bëhen publike së paku 7 ditë para mbledhjeve të rregullta dhe 3 ditë pune para mbledhjeve të jashtëzakonshme. Njoftimet publike shpallën në vendet me të frekuentuara brenda territorit të komunës, në faqen elektronike zyrtare të komunës, rrjete sociale apo forma alternative. Ndërsa, seancat e kuvendit transmetohen në kohë reale në ueb-faqe të komunës, you-tube, rrjete sociale apo çfarëdo platforme të ligjshme për të transmetuar drejtpërdrejtë ngjarjen.
10	Përbushja e kriterëve të faqes zyrtare elektronike të komunës	Treguesi matë shkallën e respektimit të obligimeve ligjore të komunës për formën dhe përmbajtjen e standardeve kryesore të faqes zyrtare elektronike, duke përfshirë popullimin me informatat e nevojshme. Faqja zyrtare elektronike e komunës është mjeti kryesor përmes të cilës komuna është e obliguar t'i publikojë informatat të cilat kërkohen për fushën e transparencë komunale. Treguesi llogaritet duke vlerësuar plotësimin e secilës të dhënë (nga e dhëna 1 deri te e dhëna 5) në faqen zyrtare elektronike të komunës, me 20%.
11	Publikimi i dokumenteve të prokurimit publik të komunës	Treguesi matë performancën e transparencës së komunës përkatëse në fushën e prokurimit publik. Matja e performancës së transparencës komunale përfshinë publikimin e dy dokumente kryesore të prokurimit: planin vjetor të prokurimit dhe raportin për realizimin e planit të prokurimit në kohën e paraparë, si dhe kontratat e komunës me kompani. Komuna brenda një periudhe prej një muaji nga dërgimi i planit përfundimtar të prokurimit në AQP duhet ta publikojë atë në faqen zyrtare elektronike të komunës. Po ashtu, kërkohet edhe publikimi i raportit vjetor për realizimin e planit të prokurimit publik, si dhe publikimi i kontratave.
12	Publikimi i raporteve për procese të konsultimeve publike	Treguesi ka për qëllim të matë cilësinë e konsultimeve publike, përkatësisht efektivitetin e kërkesave dhe sugjerimeve në politikat dhe vendimet komunale. Komunat kanë obligim të dokumentojnë kërkesat dhe sugjerimet e qytetarëve dhe t'i shqyrtojnë seriozisht. Po ashtu, komunat kanë për obligim të japin sqarim kur një kërkesë e qytetarëve në konsultim publik nuk mund të akomodohet.

		Proces i konsultimit publik këtu konsiderohet çdo konsultim për buxhet, KAB, akt komunal, plan komunal dhe dokument të politikës lokale i cili zgjatë jo më pas se 15 ditë dhe jo më shumë se 30 ditë nga data e shpalljes së njoftimit publik për mbajtje të konsultimeve.
13	Raportimi i planit vjetor të planit të integritetit para kuvendit komunal	Ky tregues ka për qëllim matjen e përmbushjes së obligimit nga ana e zyrtarëve përgjegjës të komunës, për të raportuar rregullisht punën mbi zbatimin e planit të integritetit, me ç 'rast sigurohet transparenca dhe llogaridhënia për masat anti-korruptive të parapara me planin e integritetit si instrument parandalues i korrupsionit. Përkatësisht matë zbatimin e kërkesës për raportim të planeve të integritetit të komunës. Përmes sigurimit të paraqitjes në Kuvend Komunal të raportit vjetor i aktiviteteve për zbatimin e planit të integritetit, sigurohet lidhja e qëndrueshme në mes të vendimmarrjes së nivelit politik dhe atij ekzekutiv, me qëllim të formulimit dhe sigurimit të zbatimit të politikave në interes të përmirësimit të performancës së autoriteteve komunës në aspektin e integritetit. Akti i matjes së përmbushjes së obligimit për prezantim dhe diskutim të raportit vjetor për implementimin e planit të integritetit para Kuvendit Komunal, i referohet vitit paraprak. Në këtë mënyrë vlerësohen arritjet vjetore të komunës në kuadër të zbatimit të planit të përgjithshëm të integritetit, rrjedhimisht prezantohen për diskutim dhe llogaridhënie të punës në menaxhimin aktiviteteve nga ana e autoriteteve të komunës në kuadër të planit të integritetit si instrument për parandalimin e korrupsionit.
II. MENAXHIM KOMUNAL		
IV	Menaxhimi financiar	
14	Niveli i azhurnimit të regjistrit të tatimit në pronë	Treguesi matë shkallën e përmbushjes së kërkesës për azhurnimin e regjistrit të pronave dhe tatimpaguesve për qëllim të tatimit në pronë. Në thelb, matet zbatimi i dispozitës ligjor ku kërkohet nga komuna që të kryej inspektimin në terren për të paktën 20% të të gjitha objekteve. Koncepti i treguesit është i ndërtuar me qëllim të vlerësimit të nivelit arritur në inspektimin e pronave e që në thelb përbën aktivitetin kyç për azhurnimin e regjistrit tatimor. Prej obligimit për inspektim prej 20% për arsye të verifikimit të gjendjes dhe azhurnimit në regjistër të pronave, përjashtohen pronat e kategorisë së tokave të pa ndërtuara apo parcelave, duke kufizuar obligimin për inspektim dhe azhurnim të pronave të kategorizuara si objekte (ndërtime). Periudha për të cilën kërkohen të dhënat ka të bëjë me fundin e vitit kalendarik i cili korrespondon edhe me vitin fiskal, për treguesin merren të dhënat për vitin e përfunduar.
15	Niveli i mbledhjes së faturës së tatimit në pronë (pa borxhe, interesa, ndëshkime)	Treguesi matë shkallën e përmbushjes së obligimit për pagesën e tatimit në pronë në nivel të komunës. Përkatësisht, nivelin e pagesave të mbledhura nga qytetarët tatimpagues në raport me faturimin në nivel vjetor, bazuar në ligjin në fuqi. Objekt i matjes është shkalla e inkasimit të faturimit vjetor të tatimit në pronë, duke mos përfshirë inkasimet e borxheve nga faturimet e viteve paraprake, apo inkasimet në emër të interesit apo ndëshkimeve lidhur me mos pagesën e tatimit në pronë. Periudha për të cilën kërkohen të dhënat ka të bëjë me fundin e vitit kalendarik i cili korrespondon edhe me vitin fiskal, për treguesin merren të dhënat për vitin e përfunduar.
16 a	Niveli i adresimit të rekomandimeve të Zyrës Kombëtare të Auditorit	Ky tregues ka për qëllim matjen e shkallës së përmbushjes së obligimit ligjor të organeve komunale në lidhje me zbatimin dhe adresimin e plotë të rekomandimeve të nivelit të lartë dhe të mesëm të paraqitura në formë eksplicite në raportin e ZKA. Në raportin e auditimit të ZKA (n-2), i cili i referohet

dhe 16 b		vitit fiskal (n-3), paraqiten rekomandimet për zbatim apo adresim, të cilat duhet të jenë të zbatuara dhe adresuara në formë të plotë në vitin (n-1). Pra, matja është për përmbushjen e rekomandimeve të lëshuara nga ZKA dy vite më herët për komunën përkatëse. Çdo vit Zyra Kombëtare e Auditorit bënë auditimin e jashtëm të komunave të Kosovës. ZKA-ja bënë auditimin e komunave në bazë të pasqyrave financiare dhe shqyrtojnë: a) nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit; b) nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi; c) nëse funksionet e kontrollit dhe të auditimit të brendshëm janë të përshtatshme dhe efikase; dhe d) nëse janë ndërmarrë veprimet e duhura për zbatimin e rekomandimeve të auditimit. ZKA çdo vit lëshon rekomandime për komunat të cilat pritet t'i adresojnë në vijim. Po ashtu, ZKA shqyrton edhe shkallën e përmbushjes së rekomandimeve të viteve të mëhershëm.
	Niveli i zbatimit të rekomandimeve nga auditori i brendshëm	Ky tregues ka për qëllim matjen e shkallës së zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga raportet e auditimit të brendshëm për organet komunale. Auditimi i brendshëm ofron siguri të pavarur dhe objektive për udhëheqësin e subjektit të sektorit publik për përshtatshmërinë dhe efektivitetin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit, si dhe ofron këshilla për përmirësimin e tij. Këshillat për përmirësim jepen përmes rekomandimeve për përmirësimin e veprimeve. Auditorët e brendshëm monitorojnë zbatimin e rekomandimeve në mënyrë sistematike sipas planit të veprimit. Në raportin e monitorimit të zbatimit e rekomandimeve të auditimit të brendshëm për vitit fiskal (n-1), paraqiten rekomandimet për zbatim apo adresim, të cilat duhet të jenë të zbatuara dhe adresuara në formë të plotë në vitin (n). Pra, matja është për përmbushjen e rekomandimeve të lëshuara nga auditimi i brendshëm një vit më herët për komunën përkatëse.
V	Menaxhimi i kontratave	
17	Niveli i zbatimit të planit të prokurimit	Ky tregues synon të matë performancën komunale në përmbushjen e planit përfundimtar të prokurimit të cilën e planifikon atë vit. Treguesi mat realizimin sipas aktiviteteve të planifikuara me prokurim kundrejt aktiviteteve të realizuara. Plani i prokurimit komunal duhet të përpilohet dhe publikohet në tre muajt e parë të vitit. Secili autoritet publik, përfshirë këtu institucionin komunal, duhet të përgatisë dhe të paraqes në Agjencinë Qendror për Prokurim (AQP) një planifikim vjetor fillestar për prokurim⁴⁶. Ndërsa 15 ditë pas miratimit të buxhetit të shtetit autoriteti publik, në këtë rast institucioni i komunës, duhet të përgatisë dhe dorëzoj në AQP planin përfundimtar të prokurimit. Plani duhet të përmbaj: 1. në rastin e kontratave të ardhshme për furnizim, vlerën e përgjithshme të llogaritur të prokurimit sipas lëmisë së secilit produkt, të cilin autoriteti kontraktues planifikon që ta prokurojë gjatë vitit fiskal; 2. në rastin e kontratave të ardhshme për shërbime, vlerën e përgjithshme të parashikuar sipas kategorisë së secilit shërbim, të cilin autoriteti kontraktues planifikon që ta prokurojë gjatë vitit fiskal; dhe 3. në rastin e kontratave për punë, karakteristikat thelbësore të çdo kontrate të punës, që autoriteti kontraktues planifikon ta japë gjatë vitit fiskal.
18	Përgatitja dhe publikimi i listës së pronave komunale të planifikuara për dhënie në shfrytëzim	Treguesi matë shkallën e përmbushjes së kërkesës për miratimin e listës së pronave komunale të planifikuara për dhënie në shfrytëzim me qëllim të zhvillimit të aktivitetit ekonomik. Objektiva të matjes janë dy momente, (1) lista e përgjithshme e pronave të paluajtshme të komunës e përgatitur

		dhe të publikuar; dhe (2) publikimi i listës së veçantë të pronave për vitin vijues. Koncepti merr parasysh se përgatitja e listës së miratuar me pronat komunale të planifikuara për dhënie në shfrytëzim, paraqet një tërësi të aktiviteteve të strukturuar si identifikimi inventarizimi, vlerësimi, dhe vet akti i miratimit. Pas miratimit vjen akti i shpalljes publike të listës, i cili kërkohet që të përmbajë komunikimin zyrtar për shpalljen e listës si dhe vendosjen e listës për qasje publike në uebfaqen zyrtare të komunës. Lista e përgjithshme është dokument që përmban të gjitha pronat e paluajtshme të komunës që janë regjistruar, ndërsa lista e veçantë është lista e pronave të paluajtshme që planifikohen për dhënie në shfrytëzim.
VI	Menaxhimi i burimeve njerëzore	
19	Përgatitja e planit për zhvillimin e personelit	Treguesi matë nëse Komuna ka të hartuar planin vjetor të personelit në pajtim me procesion e planifikimit buxhetor. Plani vjetor siguron që rritja dhe zhvillimi i personelit bëhet në përputhje me detyrat dhe përgjegjësitë e personelit dhe arrijten e objektivave të komunave përkatëse. Koncepti merr parasysh që plani i zhvillimit mundëson marrjen e aftësive të reja, rritjen e produktivitetit, motivimit dhe të kënaqësisë së personelit. Duke i marrë parasysh këto dhe aspektet tjera, plani për zhvillimin e personelit harmonizon qëllimet individuale dhe institucionale ku si rezultat sigurohet që shërbimet publike ofrohen në mënyrë efikase bazuar në nevoja të qytetarëve. Plani vjetor bazohet dhe përpilohet duke marrë parasysh procedurat që parashihen në ligjin dhe aktet nënligjore të ministrisë përgjegjëse.
20	Gratë në pozita udhëheqëse në institucionet arsimore, shëndetësore e kulturore/sportive	Treguesi matë nivelin e përfaqësimit të grave në pozitat udhëheqëse të institucioneve të mëposhtme: • Instituconeve shkollore nën menaxhim të komunës - institucione parashkollore publike, shkolla të cilkit të ulët dhe mesëm si dhe çdo shkolle tjetër publike të cilat menaxhohen dhe financohen nëpërmjet komunës përkatëse; • Institucioneve shëndetësore nën menaxhim të komunës - qendrave të mjekësisë familjare (QKMF, QMF-të dhe AMF-të) si dhe • Institucioneve kulturore e sportive - teatorve, sallave koncertale, fushave sportive. Pozita udhëheqëse konsiderohen drejtorët e këtyre institucioneve pra drejtorët e shkollave, QMF-ve, fushave të sportit dhe institucioneve kulturore. E dhëna e parë kërkon numrin e zyrtarëve të lartë në këto institucionet dhe ky duhet të korrespondojë me numrin e institucioneve të këtyre fushave pasi që matet udhëheqësi i këtyre. Ndërsa e dhëna e dytë kërkon sa nga ata udhëheqës janë të gjinisë femërore, derisa e dhëna e tretë kërkon numrin e pozitave udhëheqëse nga gratë të cilat vijnë nga komunitetet jo-shumicë.
21	Gra të emëruara në postet politike në komunë	Treguesi matë nivelin/numrin e përgjithshëm të grave të emëruara në pozita politike, gjegjësisht pozitat e emëruara nga niveli politik i komunës. Koncepti merr parasysh të punësuarit/emëruarit poste politike, duke siguruar se nuk janë të përfshirë edhe shërbyesit civil në listën e zyrtarëve të komunës. Konkretisht, duhet të konsiderohen: zv. kryetari, zv. kryetari për komunitete (ku është zgjedhur një i tillë), drejtorët e drejtorive komunale, si dhe këshilltarët politik dhe pozita të tjera të kabinetit të kryetarit sipas udhëzimit administrativ .
III. OFRIMI I SHËRBIMEVE		
VII	Shërbimet administrative	

22	Shërbimet administrative të thjeshtuara për zvogëlimin e barrës administrative në nivel komunal	Treguesi mat numrin e shërbimeve administrative (procedurat administrative) që do të thjeshtohen nga komuna. Komunës do t'i kërkohet të thjeshtojë 30 shërbime administrative për tre vjet, nga 10 shërbime të ndryshme për çdo vit. Thjeshtimi i një shërbimi administrativ nënkupton një nga opsionet e mëposhtme: (i) ulja e tarifës ose pagesën për shërbimin administrativ sipas parimit të mbulimit të kostos, (ii) heqja e kërkesave për dokumente (të panevojshme ose dokumente që disponon komuna) gjatë aplikimit, (iii) rritja e vlefshmërisë së procedurës, (iv) bashkimi i procedurës me një procedurë tjetër të ngjashme (v) eliminimi i procedurës (që nuk ka bazë ligjore) (v) digjitalizimi i lëshimit të procedurës nga komuna. Komunat kanë kompetencën për të zgjedhur 30 shërbime të ndryshme administrative për thjeshtim brenda kompetencave të tyre për të ulur barrën administrative. Treguesi llogaritet duke shumëzuar çdo shërbim administrativ të thjeshtuar me 10 pikë për të arritur performancën e kërkuar vjetore 100%. Megjithatë, nëse komuna thjeshton 30 procedurat në vitin e parë, atëherë komuna arrin pikët maksimale për tre vitet e ardhshme.
23	Kërkesa të shqyrtuara për leje të ndërtimit	Treguesi matë shkallën e përmbushjes së obligimeve të komunës në raport me ligjin dhe planet komunale për lëshimin e lejeve ndërtimore. Treguesi i trajton të gjitha kërkesat pavarësisht nëse ato janë apo nuk janë në përputhje me kushtet e parapara për leje të ndërtimit. Shkalla e shqyrtimit dhe miratimit të kërkesave për leje të ndërtimit tregon për kapacitetet dhe efikasitetin e komunës në menaxhimin me sukses të zbatimit të ligjit dhe planeve komunal në ndërtimin e planifikuar në territorin e komunës përkatëse. Treguesi nuk matë zbatimin e kushteve teknike të lejes së ndërtimit. Megjithatë, miratimi i kërkesave apo lëshimi i lejeve të ndërtimit, si kusht i domosdoshëm, është në funksion të plotë të përmbushjes së qëllimit të rezultetit për ndërtim të planifikuar komunal apo lokal, sepse në këtë fazë të matjes leja e ndërtimit nënkupton edhe zbatimin e saj të plotë. Kjo vjen si mundësi e një numri të kërkesave të regjistruara në vitin paraprak, por që shqyrtohen në vitin raportues të të dhënave.
VIII	Planifikimi hapësinor, transporti publik dhe mjedisi	
24	Sipërfaqja e territorit të komunave të mbuluar sipas planeve zhvillimore të komunës	Treguesi matë shkallën e mbulimit të territorit të komunës përkatëse me PZHK dhe me harta zonale, me çka ofrohen mundësi të mira për ndërtim të planifikuar të vendbanimeve. Planifikimi hapësinor është i rëndësishëm për planifikimin komunal për shkak të rolit të tij në formësimin, organizimin dhe zhvillimin të zonave urbane. Kjo mundëson alokimin e hapësirave/tokës në mënyrë strategjike për qëllime të ndryshme, si hapësira për banim, tregti, zhvillim infrastrukturor, qëndrueshmëri mjedisore, etj. Komuna harton dhe menaxhon procesin e hartimit të PZHK-së për një periudhë së paku tetë vjeçare si dhe hartimin e HZK-së, derisa Kuvendi Komunal është përgjegjës për aprovimin e planeve përkatëse dhe aprovimin e mjeteve për zbatim të planeve.
25	Vendbanimet e përfshira në transportin lokal publik	Ofrim i transportit lokal publik nënkupton mundësinë që të gjithë qytetarët e të gjitha vendbanimeve në territorin e komunës përkatëse të transportohen me transport lokal (komunal) në mënyrë të sigurt, sipas një orari të caktuar për linja të caktuara deri në destinacionin e caktuar brenda territorit të komunës. Përfshirja e të gjitha vendbanimeve në transport publik komunal paraqet kusht të domosdoshëm ligjor dhe kriter i rëndësishëm i sigurimit të lirisë së lëvizjes dhe qasjes në shërbime publike. Ky tregues e informon rezultatin drejtpërdrejt lidhur me arritjen e komunës në sigurimin e përfshirjes të të gjitha vendbanimeve në transportin lokal. Komuna, për çdo vjet ka mundësi ta shqyrtojë arritjen e vetë për këtë tregues dhe për të gjithë të tjerët, dhe ta krahasojë dhe vlerësojë

		performancën vetanake ndër vite dhe po ashtu edhe me komunat tjera, duke rritë kështu kapacitetet menaxhuese, transparencën dhe llogaridhënien lidhur me politikat e zhvilluara dhe të zbatuara në këtë fushë.
26	Realizimi i planit lokal të veprimit në mjedis	Treguesi ka për qëllim matjen e performancës së komunës përkatëse në realizimin e veprimeve të planifikuara me Planin për Veprim Lokal Mjedisor (PVL) për mbrojtjen e mjedisit dhe krijimin e një mjedisi të pastër dhe të shëndetshëm për qytetarët ⁹⁴ . Treguesi jep informata për të gjitha veprimet e ndërmarra nga komuna në partneritetet palët tjera të interesit për mbrojtjen dhe përparimin e mjedisit, të përcaktuara me Planin e veprimit komunal në mjedis dhe programet mjedisore. Nga pikëpamja e performancës komunale, miratimi i planit (PVL) dhe zbatimi i tij është përgjegjësi e komunës përkatëse në përputhje me Planin e Kosovës për veprim mjedisor, i cili ka të bëjë me mbrojtjen e tokës, ujit ajrit, klimës, ekosistemeve, llojllojshmërisë së botës bimore dhe shtazore, peizazheve, natyrës, administrimin e mbeturinave të ngurta dhe të lëngshme (ujërave të zeza), administrimin e fatkeqësive ekologjike (aksidenteve mjedisore), mbrojtjen nga zhurma etj. (Ligji për mbrojtjen e mjedisit, neni 23). Plani duhet të jetë në përputhje edhe me Hartat zonale dhe Planit rregullativ të hollësishëm të planifikimit hapësinor të komunës përkatëse dhe të planeve tjera komunale, në veçanti të planit për menaxhimin e emergjencave.
IX	Arsimi para-universitar	
27	Plotësimi i kushteve të kërkuara me infrastrukturë, pajisje dhe mjete në institucionet e arsimit parauniversitar	Treguesi matë shkallën e pajisjes me elementet e infrastrukturës shkollore, si salla të edukatës fizike, kabinete (laboratorë, punëtori), biblioteka, si dhe klasat e rregullta, të cilat për nevojat të raportimit kërkohet të jenë të pajisura plotësisht me mjete dhe pajisje, në nivelin të cilin mundësohet realizimi i aktiviteteve siç kërkohet nga kurrikulat të cilat janë në zbatim në ato institucione! Për nevojat e këtij treguesi janë të specifikuara 6 kriteret të vlerësimit si në vijim: 1. Salla e edukatës fizike me mjete dhe pajisje; 2. Kabinete (laboratorë, punëtori); 3. Biblioteka e shkollës e pajisur dhe në funksion; 4. Pajisja e klasave të zakonshme me orëndi të domosdoshme shkollore; 5. Pajisja e klasave të zakonshme me mjete elektronike për zhvillimin e aktivitetit mësimor (projektor, tabela elektronike)
28	Niveli i pajtueshmërisë me raportin e synuar nxënës për mësimdhënës	Treguesi ka për qëllim matjen shkallën e performancës, përkatësisht arritjen e komunës në sigurimin e raportit të kërkuar nxënës për mësimdhënës). Me raport të kërkuar nxënës për mësimdhënës nënkuptohet mesatarja e raporteve nxënës (20) për mësimdhënës (1). Në këtë aspekt, synohet matja e përputhshmërisë me nivelin e synuar të raportit, qoftë nga shkalla më e lartë apo nga shkalla më e ulët në drejtim të vlerës 20/1. Objekt i matjes është raporti nxënës – mësimdhënës në vendbanime urbane dhe ato rurale për arsim parauniversitar, në nivelin e institucioneve të sistemit parauniversitar për nivelet sipas ISCED 02, 1, 2 dhe 3. Nga llogaritja në trupin e mësimdhënësve nuk përfshihen mësimdhënësit e niveleve parashkollore, edhe pse janë pjesë e (ISCED). Vlera referente e raportit [20]/[1] nxënës për mësimdhënës është marrë duke ju referuar mesatares e dhëshirueshme për raportet normative nxënës-mësimdhënës.
X	Kujdesi parësor shëndetësor (KPSH)	

29	Njësitë e shëndetësisë primare me pajisje dhe shërbime laboratorike sipas udhëzimit administrativ	Treguesi ka për qëllim matjen e performancës, përkatësisht arritjen e komunës në sigurimin e pajisjeve të plota me inventar (pajisje dhe mjete) dhe shërbime laboratorike të njërive të kujdesit primar shëndetësor (QKMF, QMF dhe AMF)125, Listimi me emërtimet konkrete të inventarit të pajisjeve, mjeteve dhe shërbimeve laboratorike, është i specifikuar në shtojcën 1 dhe 2 të UA, ku theksohen në formë të pikave për secilin nivel të njësisë së mjekësisë familjare në formë të përveçme (QKMF, QMF, dhe AMF). Në këtë kontekst, komuna ka përgjegjësi si të drejtpërdrejt në kuptim të kompetencave ligjore, po ashtu edhe politike, me ç ‘rast ka përgjegjësi për të punuar me instancat e tjera për sigurimin e përmbushjes, siç është Ministria e Shëndetësisë, si dhe Inspektorati Shëndetësor. Periudha për të cilën kërkohen të dhënat ka të bëjë me gjendjen në fund të vitit.
30	Niveli i pajtueshmërisë me ekipet e mjekësisë familjare dhe shëndetit oral	Treguesi ka për qëllim matjen shkallën e performancës, përkatësisht arritjen e komunës në sigurimin e raportit të synuar të ekipeve: të mjekësisë familjare (1 specialist dhe 2 infermierë) dhe stomatologjisë (1 doktor i stomatologjisë dhe 1 teknik/asistent). Me raport të kërkuar për ekipet e specializuara janë si në vijim: ekip i mjekësisë familjare përbëhet nga mjeku familjar dhe dy infermier/e familjar, që ofrojnë kujdes individual, familjar dhe në bashkësi, që ofron shërbime për 2000 banorë; dhe ekipi i shëndetit oral përbehet një doktor i stomatologjisë dhe një teknik/asistent i stomatologjisë që ofron shërbime për 5000 banorë. Në këtë aspekt, synohet matja e përputhshmërisë me nivelin e synuar të raportit, qoftë nga shkalla më e lartë apo nga shkalla më e ulët në drejtim të vlerave të caktuar. Nga llogaritja në ekipet e lartpërmendura nuk llogariten ekipet e pakompletuara, edhe pse janë pjesë e institucionit dhe ofrojnë shërbime.

Shtojca 3: Shablloni i fletëvlerësimit dhe udhëzuesi i pikëve

Përmbledhje e rezultateve për vitin 2023 për grantin e performancës komunale - Komuna XXX Pregled rezultata za 2023 godinu za opštinski grant učinka - Opština XXX		
#	Kushti minimal Minimalni uslov	Vlerësimi Procena
1	Komunat duhet të kenë raportuar të dhënat në SMPK sipas afatit të përcaktuar	
	Opštine su trebale da prijave podatke u SUOU -u prema predviđenim rokovima	
2	Komunat duhet të kenë respektuar obligimin ligjor për t'i rishqyrtuar aktet komunale të vlerësuara si të kundërligjshme nga autoriteti mbikëqyrës	
	Opštine su se trebale pridržavati zakonske obaveze kako bi razmotrili opštinske akte koje je nadzorni organ procenio kao nezakonite	
3	Opinionit i auditimit duhet të jetë të paktën i pamodifikuar me theksim të çështjes	
	Mišljenje revizije bi trebalo da bude najmanje neizmenjeno sa naglaskom na pitanje	
4	Komunat duhet të kenë shpenzuar 75% ose më tepër të buxhetit final për investime kapitale	
	Opštine su trebale potrošiti 75% ili više konačnog budžeta za kapitalna ulaganja	
Komuna kualifikohet/nuk kualifikohet për grant të performancës komunale Opština kvalifikuje se/ne kvalifikuje se za grant opštinskog učinka		
#	Fushat dhe nënfushat e treguesve të performancës Oblasti i pod oblasti pokazatelja učinka	Vlerësimi Procena
I	Roli i Kuvendit Komunal si organ mbikëqyrës	0
	Uloga Skupštine Opštine kao nadzorni organ	
II	Pjesëmarrja, konsultimi dhe gjithëpërfshirja e qytetarëve	0
	Učešće, konsultcije i sveobuhvatnost građana	
III	Transparenca, qasja në informata dhe integriteti	0
	Transparentnost, pristup informacijama i integritet	
Vlerësimi për qeverisjen komunale Ocenjivanje za opštinsku vlast		0
IV	Menaxhimi financiar	0
	Finansijsko upravljanje	
V	Menaxhimi i kontratës	0
	Upravljanje ugovorom	
VI	Menaxhimi i burimeve njerëzore	0

	Upravljanje ljudskim resursima	
Vlerësimi për menaxhimin komunal Ocenjivanje za opštinsko upravljanje		0
VII	Shërbimet administrative	0
	Administrativne službe	
VIII	Planifikimi hapësinor, transporti publik dhe mjedisi	0
